



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
01Nr. 400/03-28129/22
Kaçanik, 26.10.2022

Në bazë të nenit 40.2 (b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 –Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-221-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048-Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr.08/L-066 -Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/31 Dhjetor 2021), të nenit 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 26 Tetor 2022, mori këtë:

V E N D I M PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE

1.Transferet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Arsimi fillorë-93810 Kodi funksional 0912, nga projekti me kod 51046 “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU 7 Shtatori Begracë” shuma prej 19,035.23€

Transferohen në kategorinë e Shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (fondi 10):

Në nën programet:

- Arsimi fillorë-93810 Kodi funksional 0912 shuma prej 14,035.23€ dhe në Nen-programin Administrata e Arsimit, Kodi funksional 0980, shuma prej 5,000.00€.

2.Transferet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Infrastruktura rrugore-18028 Kodi funksional 0451, nga projekti me kod 51036 “Rregullimi i sheshit të qytetit, faza I-rë” shuma prej 20,000.00€ dhe nga projekti me kod 51632 “Vendosja e bus-kabinave për udhëtarë përgjatë rrugëve lokale”, shuma prej 2,796.82€.

Transferohen në kategorinë e Shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (fondi 10):

Në nën programin:

Infrastruktura rrugore-18028 Kodi funksional 0451, shuma prej 22,796.82€

3. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli